



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Suedia mbështet Shqipërinë në procesin e integritimit

2018-01-12 14:20:00



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë vizitës së tij në Suedi zhvilloi një takim me Ministren e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Suedisë, Margot Wallström.

Ministrat diskutuan mbi dinamikën e shkëlqyer të marrëdhënieve dypalëshe. Të dy homologët i kushtuan vëmendje të veçantë procesit të integritimit të Shqipërisë në BE dhe ndanë mendimin për impaktin transformues që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit. Ministri Bushati vlerësoi rolin mbështetës të Suedisë për procesin e zgjerimit, në përgjithësi dhe përpjekjeve të Shqipërisë, në veçanti, në këtë proces. Ai e njohu kolegen suedeze me hapat dhe masat e ndërmarra nga Qeveria në procesin e reformave dhe plotësimin e pesë kritereve kryesore në kuadër të BE-së, duke konfirmuar vendosmërinë e qeverisë shqiptare për “zbatimin e reformës në drejtësi dhe procesin e vetting-ut”.

Ministri Bushati shprehu besimin se “viti 2018 do të jetë një vit i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë”, përmes vendimit të vendeve anëtare për hapjen e negociatave për anëtarësim.

Ministrja Wallström konfirmoi qëndrimin mbështetës të Suedisë për Shqipërinë dhe vlerësoi përpjekjet e qeverisë në procesin e reformave. “Jeni në rrugën e duhur dhe keni mbështetjen tonë”, nënvizoi ministrja suedeze.

Ministri Bushati vlerësoi mbështetjen e Suedisë për Shqipërinë përmes Strategjisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim 2014-2020, me projekte komplementare me ato të BE-së në fusha si statistikat, reforma në sistemin e drejtësisë, në sistemin e taksave, të drejtave të njeriut, ambientit, etj., duke nënvizuar gjithashtu rëndësinë e vijimit të mbështetjes për përuardhjen 2021-2027.